



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

Nr. 10/1 prot.

Lushnjë, më 11.06.2018

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar.

Kërkuesit: Qendrës : “Res Publica”

Adresa elektronike: dorian.matlija@gmail.com

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 10, datë 08.06.2018 (sipas rregjistrimit përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve).

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni:

1 Sa është numri i avokateve të caktuar kryesisht nga Gjykata për vitin 2016, 2017?

1.1 Për vitin 2016 numri i avokatëve kryesisht të caktuar nga Gjykata është 8
Për vitin 2017 numri i avokatëve kryesisht të caktuar nga Gjykata është 10

2. Sa është numri i çështjeve të gjykuara nga Gjykata dhe sa nga këto çështje janë përfaqësuar nga avokate kryesisht për vitin 2016, 2017?

2.1 Për vitin 2016 çështje penale të gjykuara nga gjykata janë 886 (te cilat janë Penale Themeli dhe Kërkesa Penale) dhe janë përfaqësuar nga avokatë kryesisht 125 çështje.

Për vitin 2017 çështje penale të gjykuara nga gjykata janë 738 (te cilat janë Penale Themeli dhe Kërkesa Penale) dhe janë përfaqësuar nga avokatë kryesisht 95 çështje.

3.Sa eshte buxheti per pagimin e avokateve te caktuar kryesisht ne proceset penale per vitin 2016, 2017 dhe sa nga ky buxhet eshte disbursuar gjate ketyre 2 viteve dhe a ka pasur teprica apo mangesi per te shlyer pagesat e avokateve kryesisht?

3.1 Buxheti për pagimin e avokatëve të caktuar kryesisht për vitin 2016 ka qënë 238500 nga Buxheti i Shtetit dhe 168000 nga të ardhurat e Gjykatës, në total **406500**

Buxheti për pagimin e avokatëve të caktuar kryesisht për vitin 2017 ka qënë 254500 nga Buxheti i shtetit dhe 25000 nga të ardhurat e Gjykatës, në total **279500**

Nuk ka asnje pagese te pashlyer për të dyja vitet.

Ju faleminderit!

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE


Kordinatori për të drejtën e informimit

Mimoza Karame




K/Deges se buxhetit

Blerta Mukaj



KANCELARI

Eugen Sylari



KRYETARE

ESMERALDA XHILI ÇEKA

